



Prishtinë: 27.02.2009

Kodi i ZRRE-së: V_161_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_172_12_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_172_12_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2009 nxori këtë:

VENDIM

REFUZHET ankesa e konsumatorit Xhafer Mehanit (shifra e konsumatorit DPR – 120624) nga Kastrioti, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 13.12.2007 ka apeluar përgjigjen e Departamenti për Konsumatorë në KEK të datës 20.07.2007, lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

- Me datë 28.06.2007 ekipi i KEK-ut ka dalur tek konsumatori dhe kanë konstatuar se para njehsorit elektrike është vendosur kabli përçues dhe se energjia rrjedh pa matje, si dhe ka regjistruar pajisjet elektrike të konsumatorit.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 00238 të datës 28.06.2007.

- Me datë 06.07.2007 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar në shumë prej 1,041.90 €.

Provë: Fatura DPR07HP03174 e datës 06.07.2007.

- Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar.
- Me datë 20.07.2007 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesin e kontrollës.

Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 20.07.2007.

- Me datë 13.12.2007 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-u në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.



- Me datë 29.12.2008 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar konsumatorin lidhur me kundërshtimit për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë ndërsa ka pranuar konsumatorin lidhur me kundërshtimin për sasinë e energjisë të llogaritur nga ana e KEK-ut për energjinë e shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar.

Provë: Përgjigja e DMK të ZRRE-së e datës 29.12.2008

- Me datë 29.01.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_172_12_08.

Provë: Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 29.01.2009

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_172_12_08** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar